



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2022:273820

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05575165

**PPP.nr.232/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I.Sh., me seli në Prishtinë, I.B, kundër debitorit K.K., SPSH “D.X-R.”, me seli në Ferizaj, rr “...”, ..., të cilin me autorizim e përfaqëson av Gazmend Rexhepi nga Ferizaj, për pagesën e gjobës, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 15.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit K.K., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.461/22, të datës 02.09.2022, i lëshuar nga përmbartuesi privat B.T. nga Ferizaj dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.461/22, i datës 02.09.2022, **PËRFUNDON** në tërësi përmbartimi në lëndën përmbartimore P.nr.461/22, si dhe **ANULOHEN** të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra sipas urdhrin për përmbartim P.nr.461/22, të datës 02.09.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.461/22, të datës 02.09.2022, Përmbartuesi privat B.T., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori I.Sh., kundër debitorit K.K., SPSH “D.X-R.”, për përmbartimin e vendimit Nr..../ AR-...9, të datës 08.03.2019, për pagesën e gjobës në shumë prej 2,000 euro dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.461/22, të datës 02.09.2022 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe gjeti se:

### **Prapësimi i debitorit është i bazuar**

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës përmbarimore në bazë të nenit 43 par. 4, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, ka vlerësuar se përmbaruesi privat B.T., urdhrin për përmbarim me numër P.nr.461/22, të datës 02.09.2022, e ka lëshuar në kundërshtim me nenin 22, par 1, nën par 1.2, nenin 24, par 3, dhe nenit 36, par 1, të LPP-së, dhe se një urdhër i tillë është i pa bazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.

Gjykata me qëllim të sqarimit të pretendimeve të debitorit në prapësim me dt.15.04.2024 ka mbajtur seancën dëgjimore publike në të cilën kanë marr pjesë vetëm debitori dhe i autorizuari i tij, kurse kreditori nuk ka marr pjesë edhe pse ka qenë i ftuar me rregulle, nuk ka ardhur dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i debitorit av Gazmend Rexhepi në seancën dëgjimore publike ka deklaruar se mbetet në tërësi në prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për përmbarim dhe ka shtuar se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit me arsyetimin se nuk ka paguar shumën e borxhit prej 2000 euro, e cila shumë sipas debitorit është shqiptuar në formë të kundërligjshme, sepse në bazë të provave që kemi prezantuar gjykatës gjendja faktike është tjetër, gjithashtu ka shtuar se kreditori ka shqiptuar gjobën ndaj debitorit me arsyetimin se kinse debitori nuk posedon licencë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, për ushtrimin e aktivitetit gjatë inspektimit të bërë me dt. 08.03.2019, ndërsa në bazë të provave që i kemi prezantuar gjykatës shihet qartë se debitori posedon licencën e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë edhe atë nga dt.31.01.2019e deri më dt. 30.01.2024. Pra me datën kur është bërë inspektimi debitori ka pasur edhe licencë. Gjithashtu i autorizuari i debitorit ka shtuar se I.Sh. me dt. 26.03.2019,

ka bërë edhe një ri inspektim tek debitori ku në procesverbal zyrtar është konstatuar se debitori është licencuar qysh nga dt. 31.01.2019 pra që vetë kreditori bie në kundërshtim me vendimin e vetë paraprak. Në fund i ka propozuar gjykatës që urdhrin e përmbaruesit privat P.nr. 461/2022 ta shfuqizoj në tërësi.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se gjatë një inspektimi të bërë nga Ministria e Shëndetësisë - I.Sh. është shqiptuar një vendim me gjobë prej 2000 euro kinse nuk posedoj licencë, në këtë vendim të dt. 11.03.2019 ka pasur edhe këshillë juridike ku si palë e kemi parashtruar ankesë pranë Kryeinspektorit shëndetësor A.B., pas kësaj nuk kam pranuar asnjë lloj vendimi dhe kreditori në këtë rast nuk posedon asnjë lloje flet kthese që kemi pranuar ndonjë vendim mbi refuzimin apo pranimin e ankesë, gjykata këto pretendime i konsideron të bazuara sepse nga provat të cilat debitori i ka bashkangjitur prapësimin të tij siç është ankesa e ushtruar kundër vendimit mbi shqiptimin e gjobës në rastin konkret si dhe dëftesa për pranimin e dërgesës e lëshuar nga Posta e Kosovës e dt. 06.04.2019, konstatohet se debitori kundër vendimit mbi shqiptimin e gjobës Nr....AR-...-19, të dt. 08.03.2019, ka ushtruar ankesë drejtuar Kryeinspektorit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe nga shkresat e lëndës nuk konstatohet se Kryeinspektori i Shëndetësisë pranë Ministrisë së Shëndetësisë të ketë vendosur me këtë ankesë. Andaj gjykata duke i marr për bazë faktet e cituara më lart vlerëson se vendimi mbi shqiptimin e gjobës në bazë të cilit është nxjerr urdhri për përmbarim nuk mund të cilësohet dokument përmbarues në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.2, si dhe nenit 24, par 3, të LPP-së sepse një vendim i tillë siç konstatohet nga shkresat e lëndës edhe pse i njëjti e përmban klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarushmëri, prapë konsiderohet se i njëjti nuk është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura administrative, nga fakti se nga shkresat e lëndës nuk shihet se kreditori i ka bashkangjitur vendimit në fjalë edhe flet kthesën mbi dorëzimin e vendimit mbi shqiptimin e gjobës debitorit dhe as që ekziston ndonjë vendim i shkallës së dytë gjegjësisht i Kryeinspektorit shëndetësor mbi ankesën e ushtuar nga debitori kundër vendimit në fjalë. Përveç tjerash, gjykata vlerëson se në rastin konkret, duke i marr për bazë faktet e cekura rrjedhë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 36 par.1 të LPP-së andaj edhe përmbaruesi privat kur e ka lejuar përmbarimin në rastin konkret me nxjerrjen e urdhrin për përmbarim P.nr. 461/22 të dt. 02.09.2022, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 22, par 1, nën par 1.2, nenit 24, par 3 dhe nenit 36, par 1, të LPP-së.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2, 3 dhe 4, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.232/21, më datë 15.04.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.